



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOLEGJI ZGJEDHOR GJYQËSOR
TIRANË

Nr.9 Regj.Them.
Datë Rregj. 24.05.2021

Nr.9 VENDIMI
Datë 31.05.2021

V E N D I M

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor i mbledhur pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë me trup gjykues të përbërë nga:

Gjyqtare: Alma KOLGJOKA (*Relatore*)

Gjyqtar: Asim VOKSHI (*Anëtar*)

Gjyqtar: Gentian MEDJA (*Anëtar*)

Gjyqtare: Manjola XHAXHO (*Anëtare*)

Gjyqtar: Sokol IBI (*Anëtar*)

me sekretare gjyqësore Erjona Torba, sot më datë 31.05.2021, në seancë gjyqësore me dyer të hapura, mori në shqyrtim çështjen me nr.9 Akti (bashkuar me çështjet nr.10 Akti dhe 12 Akti) që i përket:

PADIA E PARË:

PADITËS: **Kreshnik Merxhani**, përfaqësuar vetë në gjykim.

I PADITUR: **Komisioni Qendror i Zgjedhjeve**, përfaqësuar në gjykim me Autorizimin nr.5565 Prot. datë 31.05.2021 nga Z. Olsi Peto.

OBJEKTI:

1. Kundërshtimin e vendimit të KQZ/KAS, nr.86 datë 19.05.2021.
2. Gjykimin e çështjes në themel duke vendosur pranimin e plotë të padisë.
3. Shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve.

4. Përsëritjen e zgjedhjeve në qarkun e Gjirokastrës.

BAZA LIGJORE: Neni 145 e në vijim të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, i përditësuar.

PADIA E DYTË:

PADITËSE: **Partia Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI)**, përfaqësuar me Autorizimin nr.337 datë 03.04.2021 nga Av.Altin Kaziaj.

IPADITUR: **Komisioni Qendror i Zgjedhjeve**, përfaqësuar në gjykim me Autorizimin nr.5565 Prot. datë 31.05.2021 nga Z. Olsi Peto.

OBJEKTI: Ndryshimi i vendimit nr.86 datë 19.05.2021 të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS) në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

BAZA LIGJORE: Neni 145 e në vijim të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, i përditësuar.

PADIA E TRETË:

PADITËSE: **Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim (PD – AN)**, përfaqësuar me Autorizim nga Ivi Kaso dhe Marash Logu.

IPADITUR: **Komisioni Qendror i Zgjedhjeve**, përfaqësuar në gjykim me Autorizimin nr.5565 Prot. datë 31.05.2021 nga Z. Olsi Peto.

PERSON I INTERESUAR: **Lëvizja Socialiste për Integrim.**

Partia Socialiste e Shqipërisë përfaqësuar në gjykim me Autorizimin nr.180 Prot. datë 27.05.2021 nga Eridian Salianji dhe Maringlen Legisi.

OBJEKTI:

1. Kundërshtimi i vendimit të datës 19.05.2021 të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve (KAS) për rrëzimin e kërkesës ankimore Nr. 41 të subjektit zgjedhor Partia Demokratike–Aleanca për Ndryshim (PD-AN).
2. Shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të zhvilluara në datën 25.04.2021 në zonën zgjedhore Qarku Gjirokastrë.
3. Urdhërimin e përsëritjes së zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë në të gjithë zonën zgjedhore Qarku Gjirokastrë.

BAZA LIGJORE:

Nenet 1, 18, 35, 42, 45 dhe 64 të Kushtetutës së Shqipërisë. Nenet 6, 8 dhe neni 3, Protokoli 1 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Pikat 27 dhe 49 të Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore. Nenet 136, 137, 145, 152, 153 156, 160 dhe 161 të Kodit Zgjedhor. Nenet 14, 223 dhe 224 të Kodit të Procedurës Civile. Nenet 6 dhe 7 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”. Nenet 3 dhe 6 të Vendimit Nr. 9, datë 24.12.2020 të KQZ-së.

Gjykata pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, administroi provat në seancë gjyqësore, dëgjoi pretendimet e fundit të palëve, ku:

Pala paditëse, Kreshnik Merxhani kërkoi:

- Pranimin e padisë.
- Kundërshtimin e vendimit të KQZ/KAS, nr.86 datë 19.05.2021.
- Gjykimin e çështjes në themel duke vendosur pranimin e plotë të padisë.
- Shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve.
- Përsëritjen e zgjedhjeve në qarkun e Gjirokastrës.

Pala paditëse, Partia Lëvizja Socialiste për Integrim, kërkoi:

- Pranimin e padisë.
- Ndryshimi i vendimit nr.86 datë 19.05.2021 të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve (KAS) në Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve.

Pala paditëse, Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim (PD – AN), kërkoi:

- Pranimin e padisë.
- Kundërshtimi i vendimit të datës 19.05.2021 të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve (KAS) për rrëzimin e kërkesës ankimore Nr. 41 të subjektit zgjedhor Partia Demokratike–Aleanca për Ndryshim (PD-AN).
- Shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të zhvilluara në datën 25.04.2021 në zonën zgjedhore Qarku Gjirokastrë.
- Urdhërimin e përsëritjes së zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë në të gjithë zonën zgjedhore Qarku Gjirokastrë.

Pala e Interesuar, Partia Socialiste e Shqipërisë, kërkoi:

- Rrëzimin e plotë të padive të ngritur nga Kreshnik Merxhani, Partia Lëvizja Socialiste për Integrim dhe Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim (PD – AN), si të pabazuar në ligj dhe në prova.

Pala e paditur, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve kërkoi:

- Rrëzimin e padisë së ngritur nga subjektet politike Kreshnik Merxhani, Partia Lëvizja Socialiste për Integrim dhe Partia Demokratike–Aleanca për Ndryshim. Lënien në fuqi të Vendimit nr.86 datë 19.05.2021 të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve (KAS).

VËREN:

1. Kolegji Zgjedhor Gjyqësor i mbledhur në datën 25.05.2021 dhe në datën 26.05.2021, në zbatim të neneve 57, 158/a(ë) të Kodit të Procedurës Civile dhe neneve 154 e 155 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë me vendimin e ndërmjetëm ka vendosur “*Bashkimin e çështjes së paraqitur më pas me nr.10.akti, datë regjistrimi me paditës LSI, dhe bashkimin e çështjes së paraqitur më pas me nr.12.akti, datë regjistrimi 26.05.2021 me paditës (PD-AN) me çështjen zgjedhore të regjistruar më parë e cila mban nr.9.akti, datë regjistrimi 24.05.2021, me paditës Kreshnik Merxhani*”.

2. Pala paditëse në padinë e parë, Kreshnik Merxhani i është drejtuar Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor me kërkesë-padi më datë 24.05.2021, duke kërkuar “*Kundërshtimin e vendimit të KQZ/KAS, nr.86, datë 19.05.2021. Gjykimin e çështjes në themel duke vendosur pranimin e plotë të padisë. Shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve. Përsëritjen e zgjedhjeve në qarkun e Gjirokastrës*”.

3. Pala paditëse në padinë e dytë, Partia Lëvizja Socialiste për Integrim, i është drejtuar Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor me kërkesë-padi më datë 24.05.2021, duke

kërkuar “Ndryshimin e vendimit nr.86, datë 19.05.2021 të Komisionit të Ankimeve dhe Sanskioneve (KAS) në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve”.

4. Pala paditëse në padinë e tretë, Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim (PD – AN), i është drejtuar Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor me kërkesëpadi më datë 26.05.2021, duke kërkuar “Kundërshtimi i vendimit të datës 19.05.2021 të Komisionit të Ankimeve dhe Sanskioneve (KAS) për rrëzimin e kërkesës ankimore Nr. 41 të subjektit zgjedhor Partia Demokratike–Aleanca për Ndryshim (PD-AN). Shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të zhvilluara në datën 25.04.2021 në zonën zgjedhore Qarku Gjirokastrë. Urdhërimin e përsëritjes së zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë në të gjithë zonën zgjedhore Qarku Gjirokastrë.”.

I. FAKTET E ÇËSHTJES:

5. Presidenti i Republikës, me Dekretin nr.11700 datë 06.09.2020, kishte caktuar datën 25 Prill 2021, për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë.

6. Në datën 25.04.2021, në 12 Zonat Zgjedhore në Republikën e Shqipërisë u zhvilluan zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë. Pas përfundimit të procesit të numërimit të votave KZAZ-të përkatëse plotësuan e miratuan tabelat përmbledhëse të rezultateve për subjektet zgjedhore dhe për kandidatët për deputetë të zonave përkatëse. Zona Zgjedhore Qarku Gjirokastrë ka 7 (shtatë) zona të administrimit zgjedhor, përkatësisht ZAZ nr.76, ZAZ nr.77, ZAZ nr.78, ZAZ nr.79, ZAZ nr 80, ZAZ nr. 81 dhe ZAZ nr.82.

7. Në datë 04.05.2021, me vendimin nr.347 Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve (KSHZ) vendosi miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit për subjektet zgjedhore, për zonën zgjedhore Qarku Gjirokastrë në zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021.

Sipas tabelës përmbledhëse rezulton se kandidati i pavarur Kreshnik Merxhani, ka siguruar 148 fletë të vlefshme votimi, të ndara sipas zonave zgjedhore si vijon:

- ZAZ nr. 76, fletë votimi të vlefshme 12;
- ZAZ nr. 77, fletë votimi të vlefshme 3;
- ZAZ nr. 78, fletë votimi të vlefshme 8;
- ZAZ nr. 79, fletë votimi të vlefshme 21;
- ZAZ nr. 80, fletë votimi të vlefshme 92;
- ZAZ nr. 81, fletë votimi të vlefshme 9;
- ZAZ nr. 82, fletë votimi të vlefshme 3;

Subjekti zgjedhor Partia Socialiste për Integrim ka siguruar 5778 fletë të vlefshme votimi, të ndara sipas zonave zgjedhore si vijon:

- ZAZ nr. 76, fletë votimi të vlefshme 582;
- ZAZ nr. 77, fletë votimi të vlefshme 509;
- ZAZ nr. 78, fletë votimi të vlefshme 1000;
- ZAZ nr. 79, fletë votimi të vlefshme 752;
- ZAZ nr. 80, fletë votimi të vlefshme 2129;
- ZAZ nr. 81, fletë votimi të vlefshme 205;
- ZAZ nr. 82, fletë votimi të vlefshme 601;

Subjekti zgjedhor Partia Demokratike–Aleanca për Ndryshim (PD–AN) ka siguruar 13971 fletë të vlefshme votimi, të ndara sipas zonave zgjedhore si vijon:

- ZAZ nr. 76, fletë votimi të vlefshme 2024;
- ZAZ nr. 77, fletë votimi të vlefshme 1070;
- ZAZ nr. 78, fletë votimi të vlefshme 1404;
- ZAZ nr. 79, fletë votimi të vlefshme 1432;
- ZAZ nr. 80, fletë votimi të vlefshme 6536;
- ZAZ nr. 81, fletë votimi të vlefshme 901;
- ZAZ nr. 82, fletë votimi të vlefshme 604;

8. Kundër vendimit nr.347 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve (KSHZ) ka paraqitur ankim kandidati i pavarur Z.Kreshnik Merxhani, subjekti zgjedhor Partia Lëvizja Socialiste për Integrim dhe subjekti zgjedhor Partia Demokratike–Aleanca për Ndryshim (PD – AN).

9. Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve me vendimin nr.86 datë 19.05.2021 ka vendosur:

1. Rrëzimin e Kërkesës Ankimore nr.33 datë 09.05.2021 të paraqitur nga subjekti zgjedhor Partia Lëvizja Socialiste për Integrim;

2. Rrëzimin e Kërkesës Ankimore nr.41 datë 10.05.2021 të paraqitur nga subjekti zgjedhor Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim (PD-AN);

3. Rrëzimin e Kërkesës Ankimore nr.52 datë 10.05.2021 të paraqitur nga subjekti zgjedhor Kreshnik Merxhani, kandidat i propozuar nga një grup zgjedhësish;

4. Lënien në fuqi të vendimit nr. 347 datë 04.05.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për miratimin e tabelës përmbledhëse për rezultatin e votimit në zonën zgjedhore qarku Gjirokastrë, për subjektet zgjedhore dhe kandidatët për deputetë në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021”;

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë brenda 5 ditëve nga hyrja e tij në fuqi.

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve ka arritur në konkluzionin se:

“ 1. Shqyrtimi administrativ evidentoi raste shkeljesh të detyrimeve ligjore, të cilat formojnë kundërvajtje administrative. Shkeljet e evidentuara nuk provohet të kenë pasur ndikim në pjesëmarrjen e zgjedhësve në votim, në ushtrimin e lirë dhe të pandikuar të së drejtës së tyre apo në tjetërsimin e vullnetit. Ato nuk formojnë “shkelje që cenojnë rëndë procesin zgjedhor” dhe as “shkelje që mund të ketë ndikuar në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore”, për pasojë nuk mund të shërbejnë si shkak për të shpallur zgjedhjet të pavlefshme në një ose më shumë qendra votimi.

2. Çdo ngjarje, fakt, apo situatë e zhvilluar në zbatim apo në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi nuk formon shkelje dhe nuk mund të shërbejë si shkak për të kërkuar pavlefshmërinë e zgjedhjeve në një apo më shumë qendra votimit.

3. Çdo shkelje e pretenduar dhe që nuk mund të provohet se ka ndodhur, ose se ka pasur ndikim mbi zgjedhjet në formën e pengimit të zgjedhësve për të marrë pjesë në votim, detyrimit të tyre për të votuar në një mënyrë të caktuar, apo në formën e tjetërsimit të votës nuk mund të shërbejë si shkak për të kërkuar pavlefshmërinë e zgjedhjeve në një apo më shumë qendra votimit”.

për emigrantët, sa raste votimi të shumfishtë ka pasur në qarkun e Gjirokastrës.

10. Kandidati i pavaruar Kreshnik Merxhani, subjekti zgjedhor Partia Lëvizja Socialiste për Integrim dhe Partia Demokratike–Aleanca për Ndryshim (PD–AN) pasi janë bërë me dije me vendimin e K.A.S. duke pretenduar se ky vendim është i pabazuar në ligj dhe në prova i janë drejtuar Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë me paditë objekt gjykimi.

11. Pala paditëse, Kreshnik Merxhani, në kërkesë padinë e parë dhe gjatë gjykimit, pretendoi se:

-Në respektim të të drejtave të përcaktuara në Kodin Zgjedhor, kandidati i pavarur ka caktuar dhe çertifikuar, me shumë vërshtirësi, vëzhgues për gjatë procesit të numërimit të votave, pranë VNY-ve përkatëse.

-Janë konstatuar shkeljesh ligjore me natyrë thelbësisht zhvlerësuese të vullnetit të zgjedhësve pasi veprimet dhe mosveprimet e numëruesve në procesin e numërimit të votave, kanë qenë të atilla sa kanë ndikuar bindshëm në rezultatet e zgjedhjeve për Qarkun e Gjirokastrës, duke prodhuar kështu një rezultat i cili nuk përputhet me vullnetin e zgjedhësve.

-Në procesin e numërimit të votave në Qarkun e Gjirokastrës ka pasur shkelje të cilat prodhojnë efektin juridik të pavlefshmërisë së zgjedhjeve në këtë Qark. Në lidhje me këto pretendime paditësi i referohet pamjeve filmike që ajo

siguroi nga KQZ, gjithsej 641 orë xhirimi. Nga këto xhirime janë evidentuan 3 momente të cenimit të fletës së votimit, konkretisht:

1. Në videon me kod NVR79_ch4_main_20210426050001_20210426060001 ff, në VNV të KZAZ-ës 79, i datës 26.04.2021 në orën 05:49 deri në 05:52, është provuar se: *“..anëtarët e Grupit të Numërimit në bashkëpunim edhe më anëtarët e KZAZ-së kanë lejuar numëruesin e Tavolines Nr. 2 (i pari majtas) të ndërhyjë në fletën e votimit duke shënuar me stilolaps në hapësirën e përzgjedhjes së votës dhe duke tjetërsuar kështu vullnetin e votuesit dhe duke kryer kështu veprën penale të parashikuar nga Neni 326 të Kodi Penal “Falsifikimi i materialit zgjedhor dhe rezultateve të zgjedhjeve”.*

2. Në videon NVR79_ch2_main_20210426150000_20210426160000 si dhe në videon 360-gradëshe NVR79_ch4_main_20210426150001_20210426160001 në VNV të KZAZ-së 79, të datës 26.04.2021 është provuar se: *“...në mënyrë të përsëritur numëruesi që ndodhet i pari në krahë të majtë ndërhyr në fletët e votimit në mënyrë të përsëritur, siç dëshmohet për shembull në orën 15:38:22 deri në 15:38:27 ose në orën 15:41:25 deri në 15:41:43, duke kryer kështu veprën penale të parashikuar nga neni 326 të Kodi Penal “Falsifikimi i materialit zgjedhor dhe rezultateve të zgjedhjeve”.*

3. Në videon 360-gradëshe NVR1_ch6_main_20210426050002_20210426060002 në VNV të KZAZ-së 80, është provuar se: *“..në datën 26.04.2021 në orën 05:09:30 deri në 05:11:30, në tavolinën 3, numëruesi i parë në të majtë ndërhyr në fletët e votimit, duke kryer kështu veprën penale të parashikuar nga neni 326 të Kodi Penal “Falsifikimi i materialit zgjedhor dhe rezultateve të zgjedhjeve”.*

-Përdorimi i stilolapsit nga ana e grupeve të numërimit mbi tavolinën e numërimit dhe mbi fletët e votimit, duke vendosur shenja në fletët e votimit ka pasur si qëllim tjetërsimin e vullnetit të zgjedhësve. Veprime këto që janë të parashikua nga neni 326 i Kodit Penal, si falsifikime të materialeve zgjedhore dhe rezultateve të zgjedhjeve.

- Janë konstatuar shkeljet që lidhen me pengimin e vëzhguesëve të Paditësit. Kryetarët e shtatë (7) KZAZ-ve kanë penguar hyrjen brenda Vendeve të Numërimit të Votave (VNV) përkatëse gjatë kohës së pranimit të kutive në VNV, duke mos lejuar vëzhguesit të monitorojnë procesin e pranim-dorëzimit të kutive të votimit në kundërshtim të Kodit Zgjedhor. Kjo ka sjellë si pasojë cënimin e një ndër parimeve kryesore në një procesit atë të transparencës e parashikuar dhe në nënin 7 të Kodit Zgjedhor.

-Gjithashtu është konstatuar se Grupet e Numërimit nuk kanë bërë publike kodet e sigurisë së kutive të votimit që hapeshin në Vendet e Numërimit të Votave, duke cenuar kështu besueshmërinë e gjithë procesit të administrimit të fletëve të votimit brenda kutive të votimit. Ekziston dyshimi i bazuar mbi provat se, shkelje të tilla janë bërë me synimin për të vendosur shenja “X” të tjera nga Grupet e Numërimit të Votave në fletët e votimit, në mënyrë që të

favorizohen subjekte të tjera zgjedhore ose për të cenuar vlefshmërinë e fletëve të votimit.

-Policia e Shtetit ka zbatuar urdhra të paligjshëm të dhëna nga kryetarët e KZAZ-ve duke penguar hyrjen në VNV të vëzhguesve të akredituar të paditësit në cilësinë e kandidatit të pavarur, duke mos qenë kështu e paanshme në kryerjen e detyrave për të garantuar trajtim të barabartë të të gjitha subjekteve politike. Veprime këto të cilat vijnë në kundërshtim me nenin 3, paragrafi 7 “Parimet e përgjithshme dhe nenin 121/1 “Personat e pranishëm gjatë procesit të numërimit të votive” të parashikuara në Kodin Zgjedhor.

-Prania në masë brenda VNV-e e personave të paautorizuar (të pa akredituar), përkatësisht familjarë dhe mbështetës të shtabit të kandidatëve të subjekteve të tjera zgjedhore ka shkaktuar tensione, duke ndërhyrë me fjalë deri në përdorimin e dhunës fizike, kjo në kundërshtim me nenin 121 të Kodit Zgjedhor. Kjo situatë e shkaktuar brenda VNV-ve në Qarkun Gjirokastrë ka ndikuar drejtpërdrejt në transparencën, standardet dhe ecurinë e procesit të numërimit, kur merren parasysh shkeljet që kanë ndodhur në tavolinat e numërimit.

-Ka pasur shkelje që lidhen me vota të pavlefshme, të cilat, në total për qarkun Gjirokastrë kanë qenë 2317 fletë votimi. Vëzhguesit e kandidatit të pavarur z. Kreshnik Merxhani kanë konstatuar raste kur janë shpallur të pavlefshme shumë fletë votimi pa asnjë arsytim dhe kontestimet e atypëratyshme nga vëzhguesit e kandidatit të pavarur z. Kreshnik Merxhani nuk janë marrë parasysh nga grupi i numërimit dhe kryetari i KZAZ-së, përkatëse. Është e qartë se jemi përpara faktit që fletët e votimit janë deformuar në mënyrë të qëllimshme dhe me paramendim, jo nga qytetarët, por nga ata që kanë administruar procesin zgjedhor, duke ndikuar drejtpërdrejt dhe masivisht në rezultatet përfundimtare.

-Refuzimi i dhënies së kopjes së procesverbaleve të nënshkuara të rezultateve të numërimit të QV-ve të vëzhguesit të kandidatit të pavarur z. Kreshnik Merxhani dhe mos vendosja e këtyre procesverbaleve në hapësirën e përcaktuar nga KZAZ-ja përkatëse kanë cënuar dispozitën e përcaktuar në nenin 122/4 të Kodin Zgjedhor.

-Në fillim të procesit të numërimit masivisht KZAZ-të e qarkut nuk janë treguar në kamera ana e fletëve të votimit me vulën. Nuk janë thënë me zë, si dhe nuk janë paraqitur në kamera të Grupeve të numërimit në tavolinat e numërimit, apo ndonjë formë tjetër të shqueshme: numri i votuesve të QV-së, të fletëve të votimit në kuti/QV, apo edhe numri i fletëve të papërdorura, kodet e sigurisë së kutisë.

-Është konstatuar mbulimi me gisht gjatë procesit të numërimit, i katrorit nën numrin 13 që i përkiste kandidatit të pavarur z. Kreshnik Merxhani. Në ekranin e tavolinave të numërimit nuk është vendosur pamja e plotë e fletës së votimit.

- Është konstatuar mungesa e subjektit zgjedhor kandidatit të pavarur z. Kreshnik Merxhani, në tabelën përmbledhëse të rezultateve të një KZAZ-je.
- Sa më lart, është evident fakti se tërësia e shkeljeve të provuara me video çojnë në cenim të hapur të vullnetit të zgjedhësve në 7 KZAZ-të në Qarkun e Gjirokastrës, duke prodhuar në këtë formë për këtë qark një rezultat zgjedhor i cili nuk përkon me vullnetin e lirë të zgjedhësve.
- Sikurse parashikon neni 160 i Kodit Zgjedhor, në rast të shkeljes së ligjit me pasojë cenimin e rëndë të procesit zgjedhor, fakt i cili ka ndodhur dhe është provuar me video, ose në rastin kur tërësia e shkeljeve mund të ketë cenuar procesin zgjedhor në një masë të tillë që mund të ketë ndikuar në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore, në këto dy raste, efektet ligjore janë konstatimi dhe shpallja e pavlefshmërisë së zgjedhjeve, fakt i cili në vendimin e KQZ/KAS nuk është konstatuar, madje është rrëzuar kërkesa për pavlefshmëri të zgjedhjeve në 7 (shtatë) KZAZ-të e Qarkut Gjirokastrë.
- Sipas Kodit Zgjedhor, nenit 161, KAS duhet të konstatonte pavlefshmërinë e zgjedhjeve në këtë qark dhe duhet të urdhëronte përsëritjen e zgjedhjeve.
- Sa më lart paditësi Kreshnim Merxhani, kërkon ndryshimin e vendimit të KQZ/KAS nr. 86 datë 19.05.2021, shpalljen e pavlefshmërisë ligjore të rezultateve të zgjedhjeve në 7 (shtatë) KZAZ-të e Qarkut Gjirokastrë dhe urdhërimin e përsëritjeve të zgjedhjeve.

12. Pala paditëse, Partia Lëvizja Socialiste për Integrim, në kërkesë padinë e dytë dhe gjatë gjykimit, nëpërmjet përfaqësuesve të saj, pretendoi se:

- Me urdhrin e Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.219 datë 19.04.2021, për vendosjen në karantinë 2-javore të shtetasve shqiptarë që vijnë nga Greqia apo Maqedonia e Veriut, në thelb u është mohuar e drejta kushtetuese e zgjedhësve shqiptarë me banim në Greqi dhe Maqedoninë e Veriut, për të ushtruar të drejtën e tyre të zgjedhin lirisht për zgjedhjet e 25 Prillit 2021. Pikërisht kjo masë e propozuar dhe e marrë 4 ditë para ditës së zgjedhjeve, provoi se vendimmarrja e propozuar e Komitetit Teknik të Ekspertëve dhe akti miratues i Ministrit të Shëndetësisë, ishin akte të formësuar nga një vullnet jo objektiv, por i orientuar politikisht, që solli si pasojë direkte negative pengimin e këtyre qytetarëve për ushtrimin e së drejtës së votës.
- Urdhri i sipërcituar është një akt normativ i cili merr fuqi juridike vetëm pas botohet në Fletoren Zyrtare të RSH, ndërkohe që ky urdhër është zbatuar në faktikisht nga dat 20.04.2021, pasi në pikën kufitare, shtetasit ishin të detyruar të plotësonin formularin e vetëkarantinimit. Autoritetet shtetërore, Ministria e Shëndetësisë nuk morri asnjë iniciativë për ndryshimin e këtij qëndrimi edhe pse një masë e tillë shtrënguese është apeluar nga shoqatat e emigrantëve, gjithë partitë politike garuese si dhe nga përfaqësuesit ndërkombëtarë.

- Procesi i votimeve në Qarkun Gjirokastrë ka qenë i cënuar në thelb, pasi është cënuar e drejta kushtetuese e votuesve shqiptarë me banim në Greqi, të cilët kanë qenë të regjistruar në listën e zgjedhësve të qarkut Gjirokastrë dhe kryesisht në bashkinë Dropull, dhe janë penguar në ushtrimin e të drejtës kushtetuese të votës, e drejtë e sanksionuar në nenet 3, 17 dhe 45 të Kushtetutës së Shqipërisë.
- Partia Socialiste për Integrim pretendon se ka prova se, shtetas shqiptarë që janë banues në Greqi dhe votojnë në Bashkinë Dropull ose qarkun Gjirokastrë dhe që janë votues të Partisë Socialiste, jo vetëm se nuk e kanë respektuar këtë urdhër, por kanë ushtruar të drejtën e votës, madje kanë qenë dhe anëtare të Komisioneve Zgjedhore dhe numërues të Partisë Socialiste. Për këtë LSI ka paraqitur edhe kallëzim penal ku ka evidentuar me emrat përkatës këta persona.
- Për të vlerësuar impaktin e këtij urdhëri në procesin zgjedhor të Bashkisë Dropull, janë paraqitur rezultatet e pjesëmarrjes në zgjedhje në 10 vitet e fundit, në raport me pjesëmarrjen në zgjedhjet për Kuvendin të Vitit 2021, nga kur rezulton se numti total i votuesve në këtë zonë ka rënë ndjeshëm vetëm 2956 votues kanë shprehur vullnetin e tyre në 2021, ndërsa në vitin 2017, për Bashkinë Dropull kanë votuar 5747 shtetas, etj.
- Rezultati zgjedhor në Bashkinë Dropull ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në rezultatin e Përgjithshëm të Qarkut Gjirokastrë, pasi në një situatë eventuale të mos pengimit të shtetasve shqiptarë që jetojnë në Greqi të pjesëmarrjes në votime, shpërndarja e mandateve në Qarkun Gjirokastrë do të ishte: 2 Mandate PS, 1 Mandat LSI dhe 1 Mandat PD.
- Në vijim të këtij arsyetimi, edhe vendimi i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve Nr. 347, Datë 4.5.2021, “Për Miratimin e Tabelës Përmbledhëse për Rezultatit e votimit në zonën zgjedhore Qarku Gjirokastrë, për subjektet zgjedhore dhe për kandidatët për deputet, në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021”, është i paligjshëm dhe duhet të priset pasi ndodhemi në kushtet e parashikuara në nenin 160, pika 1 të Kodit Zgjedhor.
- Sipas të dhënave të kryqëzuara të pajisjes PEI për këtë qark, ka rezultuar që ka pasur votim të disa personave më shumë se një herë, konkretisht për 73 votues, kanë rezultuar 12 raste të identifikuar nga shenjat daktiloskopike të gishtave. Identifikimi elektronik edhe si një risi në këto zgjedhje, nuk ka mundur të shmangi votimin më shumë se një herë, gje e cila ka sjellë deformim të rezultatit.
- Analiza e fakteve dhe provave të depozituara pranë KAS në cilësinë e provave materiale është bërë jo në përputhje me parimet e përgjithshme të vlerësimit të provave, në kundërshtim me parashikimet e Kodit Zgjedhor, Kodit të Procedures Civile si dhe Kodit të Procedures Administrative. Nuk rezulton të jetë kryer një hetim i plotë e i gjithanshëm nga KAS.

-Përfundimisht kërkohet ndryshimi i vendimit të KQZ/KAS nr. 86 datë 19.05.2021, shpalljen e pavlefshmërisë ligjore të rezultateve të Qarkut Gjirokastër dhe urdhërimin e përsëritjeve të zgjedhjeve.

13. Pala paditëse, Partia Demokratike–Aleanca për Ndryshim (PD–AN), në kërkesë padinë e tretë dhe gjatë gjykimit, nëpërmjet përfaqësuesve të saj, pretendoi se:

-Vendimi i KAS është i cënueshëm, ai është marrë në shkelje të ligjit procedural dhe ligjit material, si dhe nuk është kryer një hetim i plotë e i gjithanshëm.

-Në lidhje me ligjin procedural: Subjekti zgjedhor PD – AN gjatë hetimit administrativ ka vendosur në dispozicion të KAS çdo provë të siguruar nga vetë ajo, më qëllim identifikimin e të gjitha aspekteve të paligjshmërisë që karakterizuan procesin zgjedhor të 25 prillit.

-Në kushtet kur një pjesë e provave ka qënë e pamundur të sigurohet nga subjekti, ky i fundit i ka kërkuar KAS-ti që ti drejtohet organeve të administratës shtetërore, për të vënë në dispozicion informacione, dokumente dhe çdo provë tjetër që kërkohet ose çmohet e nevojshme për hetimin administrativ.

- Kërkesa e subjektit është refuzuar nga KAS, kjo në shkelje flagrante të nenit 136, pika 1, gërma “c” dhe nenit 137 të Kodit Zgjedhor.

-Në lidhje me themelin e pretendimeve për pavlefshmëri:

-Në lidhje me pavlefshmërinë e zgjedhjeve: Kodi Zgjedhor ka përcaktuar në mënyrë të detajuar cilat janë rastet kur zgjedhjet shpallen të pavlefshme, cili është organi kompetent dhe pasojat që sjell një vendim i tillë, sipas përcaktimeve të nenit 160 të Kodit Zgjedhor. Ndërsa në rast të marrjes së një vendimi për pavlefshmërinë e zgjedhjeve në një zonë zgjedhore, neni 161, pika 1 parashikon se KQZ-ja, eventualisht Kolegji Zgjedhor urdhëron përsëritjen e zgjedhjeve në të gjithë zonën zgjedhore.

-Në rastin konkret, subjekti zgjedhor PD-AN ka parashtruar një numër të madh shkeljesh të Kushtetutës, Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Kodit të Praktikës së Mirë për Çështjet Zgjedhore dhe Kodit Zgjedhor, të cilat në tërësinë e tyre cënojnë rëndë procesin zgjedhor në një masë të tillë që ndikojnë drejtpërdrejtë në ndarjen e mandateve. Tërësia e këtyre shkeljeve krijon bindjen e plotë bazuar në fakte dhe prova të pakundërshtueshme, si dhe Kodin Zgjedhor, për shpalljen e pavlefshme dhe përsëritjen e zgjedhjeve në Zonën Zgjedhore Gjirokastër.

-Mohimi i të drejtës për të votuar i emigrantëve: Deri në datën 19 prill 2021, nuk ka pasur asnjë ndalim që emigrantët shqiptarë, të hynin në Shqipëri dhe të vendoseshin në karantinë. Komiteti Teknik i Ekspertëve pranë Ministrisë së Shëndetësisë, vetëm 1 javë para zgjedhjeve, nxori një vendim që detyronte

emigrantët që vinin nga Greqia apo Maqedonia e Veriut të karantinoheshin detyrimisht për një periudhë 2-javore. Ky vendim pengonte efektivisht 500 mijë emigrantë shqiptarë që jetojnë në Greqi, për të ushtruar të drejtën e votës, në mënyrë diskriminuese.

- Zgjedhësit, që ishin të infektuar me COVID-19 dhe që ndodheshin në karantinë, qenë të detyruar të respektonin rregullat e izolimit, duke u cënuar de facto e drejta e tyre për të votuar.

-E drejta e çdo qytetari shqiptar për të votuar është e sanksionuar në nenin 45 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, njëkohësisht është një nga të drejtat themelore e parashikuar në nenin 3, Protokoli 1 të KEDNj.

-Ndërsa në neni 24 dhe 25 të Kodit Zgjedhor, është parashikuar shprehimisht e drejtën e votimit për emigrantët shqiptar në vendin e tyre të rezidencës, mundësi kjo e cila nuk u është dhënë, duke mohuar një nga të drejtat e tyre themelore.

-Blerja e votës dhe përdorimi i personave me rekorde të tmerrshme kriminale:Në qarkun Gjirokastrë është konstatuar shitblerja e votave dhe shkeljet e tjera flagrante, janë kryer si pasojë e përfshirjes në fushatë të ish-zyrtarëve të policisë të përfshirë në skemat e mbjelljes dhe trafikimit të narkotikëve, të cilat janë rikthyer në strukturat e policisë nga vetë Ministri Brendshëm në këmbim të mbështetjes nëpërmjet lidhjeve kriminale në funksion të maksimizimit të votave për Partinë Socialiste. Në lidhje me këtë pretendim subjekti zgjedhor ka identifikuar disa raste të cilat vinë të detajuara.

-Janë identifikuar raste në të cilat provohet se individë të tjerë, punonjës të Policisë së Shtetit janë përfshirë në aktivitete të paligjshme, dhe janë angazhuan në fushatën e PS-së dhe kandidatëve të saj. Verifikimi i informacionit mund të behët nëpërmjet marrjes së provave pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Prokurorisë së Përgjithshme dhe Prokurorisë Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK). Në këmbim të mbështetjes së dhënë PS-së dhe kandidatëve të saj, drejtuesi politik i PS, në këtë qark, ka ofruar pozicione të larta në administratën shtetërore, si këshilltar i ministrit, drejtues të lartë lokalë të Policisë së Shtetit etj.

-Shitblerja e votës është një ndër problematikat kryesore të konstatuara edhe në Deklaratën e Gjetjeve dhe Rekomandimeve Paraprake të OSBE/ODIHR. Faktohet në këtë raport se deri në datën 24 prill 2021, janë hapur më shumë se 30 çështje pranë strukturave të SPAK..

-Blerja e votës nëpërmjet dhënies së bonuseve dhe përfitimeve të tjera:Shitblerja e votës u krye nëpërmjet dhënies së bonuseve dhe përfitimeve të tjera të cilat përbënin problem në procesin zgjedhor duke devijuar vullnetin e qytetarëve. Qeveria nëpërmjet akteve nënligjore ka miratuar Vendime Qeverie nëpërmjet të cilave është mundësuar dhënien e një shpërblimi në fundvit, për mjekët dhe punonjësit e Policisë së Shtetit. Është vendosur të ndryshohet

struktura dhe niveli i pagave për punonjësit e stafit mjekësor, punonjësve të tjerë me arsim të lartë dhe punonjësit e stafit teknik të shkencave mjekësore në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë, Njësisë Mjekësore Ushtarake në Spitalin Universitar të Traumës, në strukturat e Forcave të Armatosura dhe institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale. Gjithashtu është vendosur të akordohen fonde në vlera të ndryshme për kategori të ndryshme të popullsisë rurale nga fondi i posacëm për bujqësinë dhe zhvillimin rural

-Vendosja e shtetit në shërbim të Partisë, duke përdorur në mënyrë të paligjshme burimet shtetërore për devijimin e vullnetit të zgjedhësve, sikurse u cilësuan më lartë është shkelje e rëndë e neneve 78 dhe 91 të Kodit Zgjedhor.

-Investimet publike: Shteti ka vendosur investimet publike në funksion të PS-së për zgjedhjet e 25 Prill 2021. Kryeministri, ministrat, deputetët dhe Kryebashkiaket e PS përdorën investimet publike për propagandë politike. Në fakt i tillë është evidentuar dhe në Raportin Paraprak të OSBE/ODIHR.

-Intimidimi i administratës shtetërore për të mbështetur PS: Gjatë fushatës u konstatuan raste të shumta të cilat janë denoncuar vazhdimisht nga PD, sesi të gjitha nivelet e administratës vendore dhe qendrore ishin përfshirë në fushatë duke mbështetur publikisht kandidatët e PS-së. Nga viti 2017 e në vijim qeveria ka nxjerrë 28 vendime, duke shtuar numrin e punësimit në strukturat e qeverisjes vendore me 16.645 pozicione të reja. Nëpunësit civilë ishin nën presion të vazhdueshëm për të mbështetur kandidatët socialistë, në të kundërt mund të shkarkoheshin nga detyra. Nëpunës, të niveleve të ulëta dhe të mesme, të administratës në Gjirokastrë, Përmet, Këlcyrë, Memaliaj, Tepelenë, Libohovë dhe Dropull kanë denoncuar presionin e vazhdueshëm nga eprorët e tyre për të paraqitur një listë me 30 deri në 50 votues për Partinë Socialiste.

-Veç kësaj punësimi në sektorin publik u rrit ndjeshëm në periudhën parazgjedhore. Sipas INSTAT në 2020 punësimi në sektorin publik u rrit me 6% pra me 10.572 persona. Subjekti Zgjedhor PD –AN në argunetat e saj i është referuar dhe statistikave të publikuar nga Ministria e Financës

-Këto veprime janë shkelje të rënda ligjore, të cilat kanë si qëllim përfitim politik duke devijuar vullnetin e votuesve. Konstatimet e sipërcituara janë evidentuar edhe në Raportin Paraprak të OSBE/ODIHR.

-Dhënia e lejeve të legalizimit/ndërtimit gjatë fushatës zgjedhore: Deputetë të ndryshëm të Partisë Socialiste kanë shpërndarë leje legalizimi në kundërshtim me përcaktimin e Kodit Zgjedhor dhe Vendimit Nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator të KQZ-së. Në raste të përsëritura, për të cilat Partia Demokratike disponon foto dhe video, ku kandidatë për deputetë shpërndanë leje legalizimi në periudhën e ndaluar nga Kodi Zgjedhor, me qëllim të pastër elektoral. Në 20 Prill, u publikua një audiopërgjim i drejtorit të përgjithshëm të Kadastrës, gjatë një takimi me vartësit e tij, ky i fundit u *kërkon* “...që mos procedojnë më tej

me rreth 100.000 kërkesa për leje legalizimi të banesave private, të cilat me siguri do të refuzohen duke sjellë prishjen e tyre....”

- Sa më lart, paditësi PD –AN, konkludon se, është e qartë se parimi i barazisë ndërmjet palëve garuese në zgjedhje u çënuar rëndë pasi Shteti dhe Partia në pushtet (PS) u shkrinë në një. Një konstatim i tillë gjendet dhe në Raportin Paraprak të OSBE/ODIHR). Ky përdorim masiv i burimeve shtetërore, përveçse një veprimtari e paligjshme, e cila duhet hetuar dhe dënuar nga organet e drejtësisë, është në shkelje flagrante të neneve 78, 91, 92 të Kodit Zgjedhor dhe neneve 3 dhe 6 të Vendimit Nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator të KQZ-së, çka ka çënuar rëndë procesin zgjedhor, duke ndikuar drejtpërdrejtë në vullnetin e zgjedhësve, rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve dhe ndarjen e mandateve në Qarkun e Gjirokastrës.

-Përdorimi i paligjshëm i të dhënave personale: Shteti vendosi të dhënat personal në dispozicion të serverave të PS në Tiranë dhe Gjirokastrë. Në datën 11 prill, media publikoi një bazë të dhënash të 910.000 zgjedhësve që përdorte Partia Socialiste në Tiranë, duke bërë publike të dhëna personale si numri i ID, vendi i banimit, numri i telefonit dhe bindja politike e shprehur në zgjedhjet e kaluara dhe projeksionet për zgjedhjet e 2021; këto të dhëna janë marrë nga të dhëna shtetërore që qytetarët i kanë vënë në dispozicion në portalin e-albania për të marrë shërbime gjatë pandemisë, apo në institucione të tjera shtetërore për të marrë shërbime nga administrata. Rrjedhja e të dhënave personale sensitive, duke përfshirë edhe preferencat politike të zgjedhësve përbën shqetësim serioz dhe i bën zgjedhësit vulnerabil. Skandali me të dhënat personale u evidentua edhe në Raportin Paraprak të OSBE/ODIHR.

-Mbledhja, përpunimi, përdorimi dhe publikimi i të dhënave personale pa pasur miratimin me shkrim të mbajtësit të të dhënave është shkelje e rëndë e nenit 35 të Kushtetutës së Shqipërisë, nenit 8 të Konventës Evropiane dhe neneve 6 dhe 7 të ligjit “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

-Duke qenë se Shteti dhe Partia ishin të pajisur me informacion për secilin zgjedhës, përfshirë edhe bindjet e tyre politike, kjo i bëri më vulnerabël përballë pushtetit dhe më lehtësisht viktimë e presioneve apo mjeteve të tjera të kundërligjshme për të ndaluar të shprehin vullnetin e tyre lirisht, duke përdorur mekanizma të ndryshëm pengues.

-Ndryshimet e njëanshme të Kodit Zgjedhor: Në datën 30.07.2020, Kuvendi i Shqipërisë nëpërmjet ligjit 115/2020, miratoi nismën e PS-së për disa ndryshime kushtetuese. Ndryshimet e njëanshme të Kodit Zgjedhor nga Partia Socialiste, duke shkelur marrëveshjen konsensuale me KQZ-në u evidentuan si problematika edhe nga Misioni i OSBE/ODIHR.

-Numri i madh i fletëve të votimit të pavlefshme: Numri i votave të pavlefshme ishte 83.026, ose 5% e numrit total të votuesve dhe ky fakt është ndikuar nga

përmbajtja e fletës së votimit me numra dhe jo me emrat e kandidatëve, duke krijuar konfuzion ditën e zgjedhjeve.

-Miratimi i një flete votimi në kundërshtim me kriteret e përcaktuara nga neni 98 i Kodit Zgjedhor dhe pika 27 e Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore, solli një numër tejet të lart të fletëve të votimit, të cilat nëse do të ishin përkthyer në mandate mund të ndryshonin rezultatin nga 5 – 8 mandate në të gjithë Shqipërinë. Këto mandate mund të sillnin jo vetëm ndryshimin e rezultatit në qarqe të caktuara, ku diferenca ndërmjet palëve është e ngushtë, por edhe në rang kombëtar, kur dihet se partia e parë sipas rezultateve paraprake ka vetëm katër mandate më shumë se shumica e kërkuar për formimin e qeverisë

-Diskriminimi i kandidatëve gjatë procesit zgjedhor: Ligji u lejon vetëm Kryetarëve të partive, por asnjë kandidat tjetër që të kandidojë deri në 4 zona zgjedhore, ndërkohë që kandidatët e tjerë mund të kandidojnë vetëm në një zonë, gjë që përbën shkelje të së drejtës së kandidimit në kushte të barabarta, ky fakt, përbën një diskriminim në të drejtën për t'u zgjedhur, në kuptim të neneve 18 dhe 45 të Kushtetutës.

-Votimi më shumë se një herë: Një nga risitë e zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë në 25 prill 2021 ishte identifikimi elektronik i zgjedhësve. Futja e këtij mekanizmi të ri në Kodin Zgjedhor ishte kërkuar me forcë nga PD dhe kishte qenë pjesë e konsensusit të arritur ndërmjet palëve për ndryshimet e Kodit Zgjedhor në Korrik 2020. Nëpërmjet identifikimit elektronik synohej të eliminohej votimi më shumë se një herë, në të njëjtën qendër votimi apo qendra të tjera, votimi për të tretët apo votimi familjar. Por, gjithsesi ajo që mbetet problematike është fakti se nga informacionet e marra në terren nga strukturat e Partisë Demokratike rezultoi se këto fenomene nuk janë shmangur. Nga subjekti zgjedhor PD –AN jepen detaje mbi rastet konkrete.

-Si përfundim, subjekti zgjedhor PD – AN, vlerëson se, në tërësinë e tyre këto shkelje të ligjit shqiptar dhe praktikave më të mira ndërkombëtare, cënuan rëndë procesin zgjedhor, duke ndikuar drejtpërdrejtë në ndarjen e mandateve. Në këto kushte, është e qartë se vendimet e marra në kundërshtim me nenin 98 të Kodit Zgjedhor dhe pikat 27 dhe 49 të Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore, cënuan rëndë procesin zgjedhor, duke diktuar një rezultat në shpërputhje me vullnetin e zgjedhësve, e për rrjedhojë edhe ndarjen e mandateve, dhe për rrjedhojë në kuptim të nenit 160 të Kodit Zgjedhor, ky proces zgjedhor në Qarkun Gjirokastrës duhet të shpallet i pavlefshëm dhe të urdhërohet përsëritja e zgjedhjeve në këtë qark.

-Me qëllim garantimin e të drejtës së palës ankuese për një proces të rregullt ligjor, PD-AN parashtron kërkesat e saj për marrjen e provave pranë organeve të administratës publike, në përputhje me nenet 136 dhe 137 të Kodit Zgjedhor, dhe nenet 223 dhe 224 të Kodit të Procedurës Civile.

-Bazuar në nenin 42 të Kushtetutës së Shqipërisë, nenin 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, pikat 27 dhe 49 të Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore dhe nenet 158, 160 dhe 161 të Kodit Zgjedhor, përfundimisht, kërkoi: “Pranimin e padisë për shfuqizimin e vendimit nr. 86, datë 19.05.2021 të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve (KAS). Shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të zhvilluara në datën 25.04.2021 në zonën zgjedhore Qarku Gjirokastër dhe urdhërimin e përsëritjes së zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë në të gjithë zonën zgjedhore Qarku Gjirokastër”.

14. Personi i Interesuar, Partia Socialiste e Shqipërisë, gjatë gjykimit, nëpërmjet përfaqësuesve të tij, pretendoi se:

-Paditë e ngritura kundër vendimit të KAS Nr.86 datë 19.05.2021 janë të pabazuara në ligj dhe në prova dhe duhet të rrëzohen nga Kolegji. Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve ka vlerësuar drejt dhe saktë të gjitha pretendimet duke interpretuar më përpikmëri ligjin zgjedhor për mbi pavlefshmërinë e zgjedhjeve dhe përsëritjen e tyre.

Për sa i përket pretendimeve të subjektit politik Partia Demokratike–Aleanca për Ndryshim:

-Neni 160 i Kodit Zgjedhor përcakton si tipar kryesor për shkeljet e ligjit, me qëllim që ato të trajtohen si shkak për pavlefshmërinë e zgjedhjeve, peshën e tyre dëmprurëse mbi zgjedhjet. Në këto raste dëmi mund të vijë edhe nga një shkelje e vetme, por tronditëse për zgjedhësit ose rregullshmërinë e procesit Përgjatë zgjedhjeve mund të ndodhin parregullsi apo shkelje të shumta, të lehta ose të rënda, të cilat mund të kenë lidhje me aspekte të veçanta të procesit, por jo të gjitha mund të cilësohen “shkelje që çënojnë rëndë procesin zgjedhor”. Shkelje që çënojnë rëndë procesin zgjedhor janë vetëm shkeljet që ose i pengojnë/largojnë zgjedhësit në masë nga votimi, ose që i detyrojnë ata të votojnë në masë kundër vullnetit të tyre, ose që tjetërsojnë në masë votën e hedhur.

-Në interpretim të nenit 125/4 dhe 160 të Kodit Zgjedhor, në çdo rast kërkesa për pavlefshmëri duhet të përmbajë të nominuar qendrën apo qendrat e votimit për të cilat kërkohet pavlefshmëria e rezultatit zgjedhor të miratuar. Secila qendër votimi ka specifikat e veta apo shkaqe të ndryshme, të veçanta ose të përbashkëta për konstatimin e elementëve të pavlefshmërisë së zgjedhjeve dhe kjo gjithmonë në varësi të bazës faktike të pretendimit të parashtruar nga paditësat.

-Nga ana e subjektit zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë janë pretenduar fakte që lidhen me shitblerjen e votës, mohim të se drejtës për të votuar, raste të votimit të shumëfishtë, raste punësimi, dhënie ndihmash etj, por asnjëherë të provuara se sa kanë ndikuar në pengimin/largimin e zgjedhësve nga votimi, në

detyrimin e votuesve që të votojnë në një mënyrë të caktuar, apo tjetërsimin e votës. Gjithashtu ka pasur edhe kërkesa për administrim informacionesh apo provash që janë objekt i hetimeve penale nga organi kompetent.

-Po ashtu ky subjekt ka pretenduar shkelje të ligjit zgjedhor që lidhem me ushtrimin e veprimtarive të ndaluara si miratimi i V.K.M apo ndryshimeve të V.K.M) por që nuk janë ankimuar asnjëherë prej tij në KQZ.

Për sa i përket pretendimeve të Subjektit Politik Lëvizja Socialiste për Integrim:

-Paditësi L.S.I kundrejt urdhrit nr.219 datë 19.04.2021 të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale "Për karantinimin e personave që vijnë në Republikën e Shqipërisë nga Republika e Maqedonisë së Veriut dhe Greqia" si një "vendim që pengoi efektivisht 500 mijë emigrantë shqiptarë që jetojnë në Greqi për të ushtruar të drejtën e votës". Ky urdhër është kontestuar pa sukses në rrugë ligjore në gjykatën administrative të shkallës së parë Tiranë dhe në gjykatën administrative të Apelit nga subjekti ankues LSI. Subjekti ankues PD nuk ka shfrytëzuar mjetet ligjore për kontestimin e tij. Për këtë arsye, ligjshmëria e urdhrit nuk mund të vihet në diskutim. Efektet e një urdhri të ligjshëm nuk mund të formojnë shkelje. Pa shkelje nuk ka pavlefshmëri.

-Lidhur me pretendimin e tjetër të paditësit L.S.I, se disa shtetas shqiptarë që janë banues në Greqi dhe votojnë në Bashkinë Dropull, ose Qarkun Gjirokastër, të cilët pretendohet të jenë votues të Partisë Socialiste, me të drejtë KAS ka konstautuar se nuk u provua nga ankuesi nëse këta persona kanë hyrë në Shqipëri në periudhën që përkon me detyrimin e tyre për vetëizolim 2-javor.

-Lidhur me pretendimin tjetër se në ditën e zgjedhjeve, sipas Ministrisë së Shëndetësisë, numri i personave të infektuar me COVID-19 ishte rreth 23.000 Statistika e ofruar nuk saktëson se sa prej tyre janë qytetarë të qarkut të Gjirokastrës, e as faktin se sa prej tyre kanë qenë zgjedhës. Një pretendim i veçantë ka lidhje me numrin anomalisht të lartë të fletëve të votimit të pavlefshme. Në zonën zgjedhore Qarku Gjirokastër numri i këtyre votave është 2317 ose 4.83% e numrit total të votave, por ky numër nuk mund të konsiderohet anomalisht i lartë, sepse mungon baza krahasuese, fakt ky i konstatuar drejt nga KAS.

Për sa i përket pretendimeve të kandidatit të pavarur Kreshnik Merxhani:

-Pretendimet për vëzhguesit e tij nuk përbëjnë bazë faktike dhe ligjore për pavlefshmëri të zgjedhjeve, për sa kohë që filtrat dhe garancitë e tjera kanë funksionuar.

-Pretendimit se në tabelën përmbledhëse të rezultateve mungon subjekti i trembëdhjetë, kandidati i pavarur nuk mbështetet, pasi tabela është vetëm për subjektet zgjedhore parti ose koalicione. Paditësi ka bërë një interpretim të gabuar të rolit dhe funksionit që ka tabela në administrimin e procesit.

-Pretendimi tjetër i lidhur me pamundësinë për të lexuar nga materialet e videove, një numër të kufizuar fletësh votimi, nuk mbështet dot kërkesën e tij

për pavlefshmërinë e zgjedhjeve. Vlen të theksohet se në një pjesë të rasteve, fleta tregon votë për subjekte të tjera, por nuk zbulon nëse ka patur shënime mbi kandidatët e pavarur. Këto raste nuk tregojnë tjetërsim në masë të rezultatit të zgjedhjeve, që do të ishte kusht për pavlefshmëri.

-Në tërësinë e tyre, të gjitha faktet apo ngjarjet e pretenduar prej padtësave përveçse janë të paprovueshme për kundërligjshmërinë e tyre, nuk referojnë në të paktën një qendër votimi qarkun e Gjirokastrës dhe nuk parashtrohet asnjë arsyetim i detajuar sipas kërkeve të ligjit. Ky është tregues i padiskutueshëm se shkaqet e pretenduara nuk janë gjë tjetër vecse parashtrime formale pa asnjë thelb të njohur nga ligji zgjedhor.

-Edhe sikur të kishte patur shkelje ligji, këto shkelje duhet që të kenë ndodhur në qendrën e votimit dhe jo në vend të tjera, si edhe të kene ndikuar në shpërndarjen e mandateve.

-Sipas nenit 160, pika 4 të K.Z parashikohet se " Shqyrtimi i kërkesave bëhet sipas procedurave të percaktuara në pjesën X të këtij Kodi. KOZ-ja, në marrjen e vendimit për pavlefshmërinë e zgjedhjeve, mund konsultohet me KZAZ-në përkatëse". Nga kjo dispozite kuptojmë se shkeljet përveçse, duhet të kenë ndodhur në ambjentet e qendrës së votimit, duhet që të jetë mbajtur edhe një raport nga K.Z.A.Z ose informationi t'i jete referuar KZAZ me shkrim nga qendra e votimit.

-Për sa më sipër, konkludohet qartë se rezultatet e tabelës përmbledhëse për rezultatin në zonën zgjedhore, Qarku Gjirokaster për zgjedhjet datës 25 Prill 2021 janë të mbledhura e miratuara sipas nenit 123 të Kodit Zgjedhor.

-Për sa kohë, në asnjë moment nuk provohet sipas ligjit pavlefshmëria e zgjedhjeve në qendrën e votimit, edhe kërkimi tjetër për përsëritjen e tyre sipas nenit 161 të K.Z mbetet i pa bazuar në ligj dhe në prova.

15. Pala e paditur, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nëpërmjet përfaqësuesve të tij, gjatë gjykimit pretendoi se:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në parashtrimet e tij, pretendon se vendimi objekt ankimi është i argumentuar dhe i bazuar në prova dhe në ligj e si i tillë duhet të lihet në fuqi.

Referuar kërkimit të subjekteve zgjedhorë në paditë e tyre, KQZ në lidhje me kërkimin për pavlefshmërinë e zgjedhjeve ka kërkuar pretendon se:

Pretendimet lidhur me subjektin zgjedhor Kreshnik Merxhani.

-Mungesa e vëzhguesve të akredituar për subjektin zgjedhor z. Kreshnik Merxhani gjatë procesit të numërimit të votave apo pengimi i tyre për t'u futur në VNV, formon parregullsi procedurale por jo pavlefshmëri të zgjedhjeve, për sa kohë që filtrat dhe garancitë e tjera të percaktuara në Kodin Zgjedhor kanë funksionuar, kjo referuar dhe parashikimeve të nenit 160 të Kodit Zgjedhor.

-Pretendimi lidhur me pamundësinë për të lexuar nga materialet e videove, një

numër të kufizuar fletësh votimi, nuk mbështet dot kërkesën e tij për pavlefshmërinë e zgjedhjeve. Vlen të theksohet se në një pjesë të rasteve, fleta tregon votë për subjekte të tjera, por nuk zbulon nëse ka patur shënime mbi kandidatët e pavarur. Këto raste nuk tregojnë tjetërsim në masë të rezultatit të zgjedhjeve, që do të ishte kusht për pavlefshmëri.

-Pamjet filmike të depozituara nga z. Merxhani nuk kanë vlerë provuese për KAS, pasi ankuesi nuk ka identifikuar shkeljet që pretendon dhe nuk ka treguar se ku është prova që kërkon të merret nga KAS, duke i kërkuar këtij Komisioni ta identifikojë dhe ta nxjerrë atë.

Pretendimet lidhur me subjektin zgjedhor koalicioni Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim

-Subjekti zgjedhor koalicioni Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim, pretendon se ka pasur shitblerje votash, nëpërmjet përfshijes së njerëzve me rekorde kriminale në fushatë zgjedhore si dhe nëpërmjet dhënies së bonuseve dhe përfitimeve të tjera. KAS vendosi se provat e paraqitura prej këtij subjekti ankues dhe të pranuar për shqyrtim nga KAS-i nuk faktojnë sa raste shitblerje vote, sa raste iejesh legalizimi, sa raste punësimi, sa raste mohimi të së drejtës për votim për emigrantët, sa raste votimi të shumfishtë ka pasur në qarkun e Gjirokastrës. Po kështu, ato nuk faktojnë se sa kanë ndikuar në pengimin/largimin e zgjedhësve nga votimi, në detyrimin e votuesve që të votojnë në një mënyrë të caktuar, apo tjetërsimin e votës secili prej këtyre fenomeneve, apo edhe i formave të tjera të përdorimit të burimeve shtetërore, i dhënies së ndihmave apo i ushtrimit të presionit mbi zgjedhësit. Subjekti ankues nuk kishte siguar asnjë prove nga institucione të tjera shtetërore, por kërkoi që KQZ-jaf i merrte ato.

-U pretendua nga subjekti ankues se, nga Partia Socialiste kishte keqpërdorim të të dhënave personale rreth të ashtuquajturit skandali i patronazhistëve, i cili ka lidhje me një bazë të dhënash prej rreth 900 mijë zgjedhësish, ku ishin fiksuar ndër të tjera, dhe preferencat e aluduara politike të tyre. KAS u shpreh se përdorimi, përpunimi dhe ruajtja e të dhënave personale rregullohet nga ligji për mbrojtjen e të dhënave personale. Rrethanat e lidhura me skandalin e patronazhistëve provojnë shkallën e ulët të respektimit të rregullave të vendosura nga ky ligj në Shqipëri. Provat e paraqitura në këtë kontekst provojnë sensibilitetin ndaj ngjarjes, por jo ndikimin e saj tek votuesit. Subjekti ankues nuk solli prova se publikimi mund të kishte intimiduar zgjedhësit dhe t'i kishte mbajtur ata larg nga procesi i votimit.

-Subjektet ankuese ngritën pretendime kundrejt urdhrit nr.219, datë 19.04.2021 të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale "Për karantinimin e personave që vijnë në Republikën e Shqipërisë nga Republika e Maqedonisë së Veriut dhe Greqia" si një "vendim që pengoi efektivisht 500 mijë emigrantë shqiptarë që jetojnë në Greqi për të ushtruar të drejtën e votës". Urdhri i

sipërcituar është motivuar me nevojën për të dominuar përhapjen e epidemisë Covid-19, në kushtet e “kontakteve më intensive në popullatë deri në përfundim të festës dhe veprimtarive fetare të lidhura me pashkët ortodokse”. Vetizolimi i personave që hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë është një masë që është marrë në mënyrë të përsëritur që nga koha e nisjes së pandemisë dhe ka qenë e lidhur me statistikat e sëmundshmërisë dhe pritshmëritë nga ngjarje të caktuara. Mbyllja, Izolimi apo vetizolimi kanë qenë masa dominuese edhe në rastet e festave të tjera zyrtare, publike ose fetare. Në kohën që u mor kjo masë Republika e Greqisë ka pasur në fuqi izolimin 14 ditor dhe numrin e kufizuar të hyrjeve për personat që hynin në territorin grek nga Shqipëria. Më vonë kjo masë u shndërrua në izolim 7 ditor. Shqipëria e mbajti në këmbë këtë masë deri më datën 3 maj 2021, d.m.th. deri pas festës. Urdhri nr.219, datë 19.04.2021 është kontestuar pa sukses në rrugë ligjore në gjykatën administrative të shkallës së parë Tiranë dhe në gjykatën administrative të Apelit nga subjekti ankues LSI. Subjekti ankues PD nuk ka shfrytëzuar mjetet ligjore për kontestimin e tij. Për këtë arsye, ligjshmëria e urdhrit nuk mund të vihet në diskutim. Efektet e një urdhri të ligjshëm nuk mund të formojnë shkelje. Pa shkelje nuk ka pavlefshmëri.

-Neni 160 i Kodit Zgjedhor përcakton si tipar kryesor për shkeljet e ligjit, me qëllim që ato të trajtohen si shkak për pavlefshmërinë e zgjedhjeve, peshën e tyre dëmprurëse mbi zgjedhjet. Në këto raste dëmi mund të vijë edhe nga një shkelje e vetme, por tronditëse për zgjedhësit ose rregullshmërinë e procesit Përgjatë zgjedhjeve mund të ndodhin parregullsi apo shkelje të shumta, të lehta ose të rënda, të cilat mund të kenë lidhje me aspekte të veçanta të procesit, por jo të gjitha mund të cilësohen “shkelje që çënojnë rëndë procesin zgjedhor”. Shkelje që çënojnë rëndë procesin zgjedhor janë vetëm shkeljet që ose i pengojnë/largojnë zgjedhësit në masë nga votimi, ose që i detyrojnë ata të votojnë në masë kundër vullnetit të tyre, ose që tjetërsojnë në masë votën e hedhur. Kriteri ligjor për matjen e ndikimit përcaktohet nga neni 161 i Kodit dhe është gjithmonë numerik.

-Arsyetimi i paditësit Partia Demokratike konsiston në argumentimin e veprimit kumulativ të një serie shkeljesh dhe parregullsish të supozuara ose të provuara të cilat kanë degraduar zgjedhjet në atë masë, sa që rezultati i tyre është jo legjitim dhe zgjedhjet duhet të shpallen të pavlefshme në të gjithë zonën zgjedhore. Sipas paditësit, pretendimi do mund të provohej kryesisht nga rezultatet e kërkimit të tij drejtuar institucioneve, i cili u rrëzua nga KAS-i. Subjekti paditës nuk ka pasur në dispozicion, nuk ka pasur dijeni dhe nuk mund të parashikonte përfundimet që mund të dilnin nga prova të cilat nuk ekzistonin në momentin e ngritjes së pretendimit Pretendimi i ngritur kryesisht mbi hipoteza është një pretendim kryesisht i pa inbështetur në prova.

-Kodi Zgjedhor ka përpunuar mjete ligjore të ndryshme për shkelje të ndryshme. Për një pjesë prej tyre mjeti ligjor është gjoba administrative (shkeljet e kryera nga media, subjektet zgjedhore, përfaqësuesit e institucioneve), për një pjesë janë masat disiplinore (shkarkimi etj.), për një pjesë është ndjekja penale (shitblerja e votës, shpërdorimi i detyrës, korrupsioni aktiv dhe pasiv në zgjedhje etj.), por për asnjërën prej tyre Kodi nuk ka përcaktuar si mjet ligjor pavlefshmërinë e zgjedhjeve. Kjo është arsyeja pse ekzistenca e një apo më shumë shkeljeve, qofshin këto edhe të rënda, nuk është shkak i vetëmjaftueshëm për të kërkuar pavlefshmëri. Kjo është arsyeja pse kërkesat për pavlefshmëri duhet të shoqërohen patjetër me argumentimin juridik që vërteton se shkelja e pretenduar është “shkelje që cënon rëndë procesin zgjedhor”, sikurse duhet të shoqërohen edhe me provën se sa dhe si e ka cënuar ajo procesin zgjedhor.

Subjekti zgjedhor Partia Lëvizja Socialiste për Integrim

- Për KAS-in rezulton i pambështetur në ligj pretendimi se përbëjnë shkelje: - nxjerrja e urdhrin nr.219, datë 19.04.2021 të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale "Për karantinimin e personave që vijnë në Republikën e Shqipërisë nga Republika e Maqedonisë së Veriut dhe Greqia" dhe mohimi, për këtë shkak, i të drejtës së emigrantëve për të votuar; - moskrijimi i kushteve për të votuar për personat e sëmurë me Covid-19;
- miratimi nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, pa pëlqimin e subjektit ankues, i ligjit nr. 115/2020 “Për disa ndryshime në ligjin nr.8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar” dhe i ligjit nr. 118/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”; - numri i lartë i votave të pavlefshme për zonën zgjedhore; - e drejta e kryetarëve të subjekteve zgjedhore për të kandiduar në më shumë se një zonë zgjedhore; - kryerja e punëve apo investimeve publike gjatë fushatës zgjedhore;
- Argumentet e secilit prej ankimesve duhet të jenë konkrete, të faktueshme, të provueshme dhe të matshme. Kërkesat që burojnë nga dispozita e pikës 1 të nenit 160 të Kodit Zgjedhor janë konfirmuar edhe nga jurisprudenca kushtetuese dhe zgjedhore shqiptare. Vendimi nr.75, datë 19.04.2002 i Gjykatës Kushtetuese, i cili mund të shërbejë si bazë për të identifikuar metodologjinë për saktësimin dhe konkretizimin e termit “shkelje që cënojnë rëndë procesin zgjedhor”, kërkon që arsyetimi juridik i KAS- it të kalojë nëpërmjet “përcaktimit të kriterëve, koncepteve bazë si dhe parimeve mbi të cilat duhet të mbështetet organi kompetent për të konkluduar lidhur me aplikimin e shkakut të përshtatshëm kushtetues”, Shkeljet që cënojnë rëndë procesin zgjedhor duhet të jenë shkelje të tilla që e bëjnë të pavlerë rezultatin e tyre, sikurse “aktet e sjelljet që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën..(duhet

të jenë të tilla që) e bëjnë të painundur kryerjen e mëtejshme të funksioneve kushtetuese” për zyrtarin e lartë.

-Shqyrtimi administrativ evidentoi raste shkeljesh të detyrimeve ligjore, të cilat formojnë kundërvajtje administrative. Shkeljet e evidentuara nuk provohet të kenë pasur ndikim në pjesëmarrjen e zgjedhësve në votim, në ushtrimin e lirë dhe të pandikuar të së drejtës së tyre apo në tjetërsimin e vullnetit. Ato nuk formojnë “shkelje që cenojnë rëndë procesin zgjedhor” dhe as “shkelje që mund të ketë ndikuar në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore”, për pasojë nuk mund të shërbejnë si shkak për të shpallur zgjedhjet të pavlefshme në një ose më shumë qendra votimi.

-Çdo ngjarje, fakt, apo situatë e zhvilluar në zbatim apo në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi nuk formon shkelje dhe nuk mund të shërbejë si shkak për të kërkuar pavlefshmërinë e zgjedhjeve në një apo më shumë qendra votimit.

-Çdo shkelje e pretenduar dhe që nuk mund të provohet se ka ndodhur, ose se ka pasur ndikim mbi zgjedhjet në formën e pengimit të zgjedhësve për të marrë pjesë në votim, detyrimin të tyre për të votuar në një mënyrë të caktuar, apo në formën e tjetërsimit të votës nuk mund të shërbejë si shkak për të kërkuar pavlefshmërinë e zgjedhjeve në një apo më shumë qendra votimi.

16. Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, pasi analizoi dispozitat ligjore, administroi provat shkresore dhe dëgjoi pretendimet e palëve, çmon se paditë e palëve paditëse Kreshnik Merxhani, Partia Lëvizja Socialiste për Integrim dhe Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim, janë të pambështetura në prova dhe në ligj dhe si të tilla duhet të rrëzohen.

17. Kolegji Zgjedhor Gjyqësor konstaton se neni 160 i Kodit Zgjedhor përcakton si tipar kryesor për shkeljet e ligjit, me qëllim që ato të trajtohen si shkak për pavlefshmërinë e zgjedhjeve, peshën e tyre dëmprurëse mbi zgjedhjet. Shkelje që cenojnë rëndë procesin zgjedhor janë vetëm shkeljet që ose i pengojnë/largojnë zgjedhësit në masë nga votimi, ose që i detyrojnë ata të votojnë në masë kundër vullnetit të tyre, ose që tjetërsojnë në masë votën e hedhur. Kodi Zgjedhor ka përpunuar mjete ligjore të ndryshme për shkelje të ndryshme. Për një pjesë prej tyre mjeti ligjor është gjoba administrative (shkeljet e kryera nga media, subjektet zgjedhore, përfaqësuesit e institucioneve), për një pjesë janë masat disiplinore (shkarkimi etj.), për një pjesë është ndjekja penale (shitblerja e votës, shpërdorimi i detyrës, korrupsioni aktiv dhe pasiv në zgjedhje etj.), por për asnjërën prej tyre Kodi nuk ka përcaktuar si mjet ligjor pavlefshmërinë e zgjedhjeve. Kjo është arsyeja pse ekzistenca e një apo më shumë shkeljeve, qofshin këto edhe të rënda, nuk është shkak i vetëmjaftueshëm për të kërkuar pavlefshmëri. Kjo është arsyeja pse kërkesat për pavlefshmëri duhet të shoqërohen patjetër me argumentimin

juridik që vërteton se shkelja e pretenduar është “shkelje që cënon rëndë procesin zgjedhor”, sikurse duhet të shoqërohen edhe me provën se sa dhe si e ka cënuar ajo procesin zgjedhor.

18. Gjithashtu në nenin 160 gërma ‘a’ e tij, është parashikuar shprehimisht se këto shkelje të ligjit, të cilat kanë cënuar rëndë procesin zgjedhor ose kur tërësia e shkeljeve të ligjit mund të këtë cënuar procesin zgjedhor në një masë të tillë që të mund të këtë ndikuar në ndarjen e mandatave në zonën zgjedhore, duhet ti referohen një ose disa qëndrave të votimit konkrete dhe jo qarkut në tërësi. Në këto kushte, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor konstaton se nga palët ndërgjyqëse nuk është pretenduar dhe as provuar shkelja konkrete e ndodhur në një qëndër zgjedhore konkrete, ashtu siç e përcakton dhe e kërkon ligji, por pretendohet në mënyrë të përgjithshme pavlefshmëria e zgjedhjeve në të gjithë Qarkun e Gjirokastrës, që përmban në vetvete 7 Zona të Administrimit Zgjedhor (ZAZ). Nga provat e paraqitura prej palëve ndërgjyqëse dhe të pranuar për shqyrtim nga KAS-i nuk faktohet se sa raste shitblerje votash ka ndodhur, sa raste lejesh legalizimi janë dhënë, sa raste punësimi janë kryer, sa raste mohimi të të drejtës për votim për emigrantët kanë ndodhur, sa raste votimi të shumfishtë ka pasur në qarkun e Gjirokastrës. Po kështu, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor çmon se ato nuk faktojnë se sa secili prej këtyre fenomeneve, apo edhe i formave të tjera të përdorimit të burimeve shtetërore, i dhënies së ndihmave apo i ushtrimit të presionit mbi zgjedhësit kanë ndikuar në pengimin/largimin e zgjedhësve nga votimi, në detyrimin e votuesve që të votojnë në një mënyrë të caktuar, apo tjetërsimin e votës.

19. Në lidhje me pretendimin e palëve ndërgjyqëse përsa i përket Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1076 datë 24.12.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.555 datë 11.8.2011 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve me arsim të lartë dhe të punonjësve të infermieristikës në sistemin e ministrisë së shëndetësisë dhe njësinë mjekësore ushtarake pranë spitalit universitar të traumës, si dhe për trajtimin e personelit mjekësor në strukturat e forcave të armatosura”, të ndryshuar, konstatohet se ky vendim ka dalë brenda periudhës së ndalimit dhe sjell rritje pagash për kategori të caktuara punonjësish publikë. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.1044 datë 18.12.2020 “Për një shtesë në vendimin nr. 929, datë 17.11.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”, të ndryshuar” është miratuar përpara fillimit të periudhës së ndalimit, prandaj nuk përbën shkelje, sikurse miratimi i vendimit nr.1102 datë 24.12.2020 “Për përcaktimin e kriterëve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë e zhvillimin rural, për vitin 2021” nuk përbën shkelje, sepse ai është vendim procedurash dhe kriteresh lidhur me një

fond që është dhënë me ligjin për buxhetin e vitit 2021. Shkelja e kryer në favor të subjektit zgjedhor PS me nxjerrjen e VKM nr.1076 datë 24.12.2020 përbën kundërvajtje administrative sipas nenit 172 të Kodit Zgjedhor. Nga pohimet e përfaqësuesve të administratës së KQZ-së rezulton se PD nuk ka bërë ankim në KQZ për këtë shkelje. Vendimi nr.1151 datë 24.12.2021 “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2021, në njësitë e Qeverisjes Qendrore” nuk është vendim për marrje në punë, por është një akt kuadër që përcakton numrin e personave që do të punësohen në institucionet përkatëse. Subjekti ankues PD-AN nuk arriti të provonte se ky vendim është marrë për qëllime zgjedhore. Ndër të tjera, nuk provohet nëse këta persona janë punësuar efektivisht në bazë të këtij vendimi.

20. Përsa i përket pretendimit të palëve ndërgjyqëse rreth debatit mediatik rreth të ashtuquajturit skandali i patronazhistëve, i cili ka lidhje me një bazë të dhënash prej rreth 900 mijë zgjedhësish, ku ishin fiksuar, ndër të tjera, dhe preferencat e aluduara politike të tyre, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor çmon se pala paditëse nuk solli prova se publikimi mund të kishte intimiduar zgjedhësit dhe t’i kishte mbajtur ata larg nga procesi i votimit.

21. Përsa i përket pretendimit të palëve paditëse në lidhje me mohimin e mundësisë së shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë shtetit që të votojnë në zgjedhjet për Kuvendin, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor konstaton se Komisionit Rregullator i është lënë kompetenca e posaçme që të vendosë “zhvillimin për herë të parë të votimit nga jashtë vendit, mbështetur në raportimin e Komisionerit për plotësimin e masave tekniko-organizative që mundësojnë votimin” (shkronja “ç” e pikës 2 të nenit 20). Në zgjedhjet e 25 prillit 2021 Komisioni Rregullator nuk e shfrytëzoi këtë kompetencë, duke mos e ligjëruar mundësinë e kësaj kategorie zgjedhësish të votonin në distancë. Në këto zgjedhje mund t’a shfrytëzonin këtë mundësi, nëse do bëhej e aplikueshme, vetëm 3613 zgjedhës nga 4572 shtetas të regjistruar me banim jashtë shtetit (të dhënat janë marrë nga KQZ-ja). Për shkak të mosaplikimit të votimit nga jashtë vendit, e drejta e tyre e votimit do të realizohej në këto zgjedhjeve vetëm nëpërmjet paraqitjes në qendrën e tyre të votimit. Ky modalitet votimi është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Pamundësia e votimit në distancë në këto zgjedhje për shtetasit shqiptarë me banim jashtë shtetit nuk formon shkelje, duke mos sjellë as pavlefshmëri.

22. Përsa i përket pretendimit të palëve paditëse kundrejt urdhrit nr.219 datë 19.04.2021 të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale "Për karantinimin e personave që vijnë në Republikën e Shqipërisë nga Republika e Maqedonisë së Veriut dhe Greqia" si një “vendim që pengoi efektivisht 500 mijë emigrantë shqiptarë që jetojnë në Greqi për të ushtruar të drejtën e votës”, Kolegji Zgjedhor

Gjyqësor çmon se është i pambështetur në ligj. Urdhri i sipërcituar është motivuar me nevojën për të dominuar përhapjen e epidemisë Covid 19, në kushtet e “kontakteve më intensive në popullatë deri në përfundim të festës dhe veprimtarive fetare të lidhura me pashkët ortodokse”. Urdhri nr.219 datë 19.04.2021 është kontestuar pa sukses në rrugë ligjore në Gjykatën Administrative të Shkallës së parë Tiranë dhe në Gjykatën Administrative të Apelit nga pala paditëse LSI. Pala paditëse PD nuk ka shfrytëzuar mjetet ligjore për kontestimin e tij. Për këtë arsye, ligjshmëria e urdhrit nuk mund të vihet në diskutim. Efektet e një urdhri të ligjshëm nuk mund të formojnë shkelje.

23. Përsa i përket pretendimit të palës paditëse Lëvizja Socialiste për Integrim, të cilët parashtruan se disa shtetas shqiptarë që janë banues në Greqi dhe votojnë në Bashkinë Dropull, ose Qarkun Gjirokastrë, të cilët pretendohet të jenë votues të Partisë Socialiste, jo vetëm që nuk e kanë respektuar këtë urdhër, por ata kanë ushtruar të drejtën e votës, madje kanë qenë dhe anëtarë të Komisioneve Zgjedhore dhe numërues të Partisë Socialiste; Kolegji Zgjedhor Gjyqësor konstaton se nuk u provua nga ankuesi nëse këta persona kanë hyrë në Shqipëri në periudhën që përkon me detyrimin e tyre për vetëizolim 2-javor. Kolegji çmon se personat që ndodhen në kushtet e vetëizolimit dhe e thyejnë atë për çfarëdo motivi, janë duke shkelur dispozitat ligjore në fuqi për administrimin e procesit të vetëizolimit, por jo dispozitat e Kodit Zgjedhor. Nga këndvështrimi i objektit të kërkesës ankimore, pjesëmarrja ose jo e personave që ndodhen në vetëizolim, në procesin zgjedhor, nuk përbën kusht për pavlefshmëri. Nga ana tjetër, ky fakt nuk përjashton përgjegjësinë e tyre sipas legjislacionit në fuqi.

24. Përsa i përket pretendimit të palëve paditëse se në ditën e zgjedhjeve, sipas Ministrisë së Shëndetësisë, numri i personave të infektuar me COVID-19 ishte rreth 23.000, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor konstaton se Statistika e ofruar nuk saktëson se sa prej tyre janë qytetarë të qarkut të Gjirokastrës, e as faktin se sa prej tyre kanë qenë zgjedhës.

25. Përsa i përket pretendimit që ka lidhje me numrin anomalisht të lartë të fletëve të votimit të pavlefshme, konstatohet se në zonën zgjedhore Qarku Gjirokastrë numri i këtyre votave është 2317 ose 4.83% e numrit total të votave, por ky numër nuk mund të konsiderohet anomalisht i lartë, sepse mungon baza krahasuese. Pas ndryshimeve të fundit të Kodit Zgjedhor, votuesve iu dha mundësia të ushtronin të drejtën e tyre, duke hedhur dy vota, një për subjektet dhe një tjetër për kandidatët. Statistika nuk mund të krahasohet me votimet e kryera në Shqipëri, kur zgjedhësit kanë hedhur vetëm një votë.

26. Pala paditëse Partia Demokratikë-Aleanca për Ndryshim ka përfshirë në ankim një numër provash që bëjnë fjalë për individë të aluduar me rekorde të tmerrshme kriminale, të cilët janë të lidhur me interesa biznesi me shumicën qeverisëse dhe që janë përfshirë “si eksponentë që kontribuonin në këtë fushatë edhe për shkak të përfitimeve që kanë marrë nga PS”. Faktet e referuara në provat e depozituara dhe në shtjellimin e kërkesës ankimore nuk krijojnë lidhje faktike dhe logjike me shkelje të Kodit Zgjedhor dhe nuk provojnë kërkesën për shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve.

27. Pala paditëse Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim e ka mbështetur kërkesën e vet për pavlefshmëri edhe në deklaratën e Misionit vëzhgues të OSBE/ODIHR-it për gjetjet dhe konkluzionet paraprake, të datës 26.04.2021. Sipas gjetjeve dhe konkluzioneve të kësaj deklarate të ODIHR, ka përhapje të fenomenit, blerja e votave është e pranishme si metodë së paku tek partitë e mëdha. Gjithsesi, përmasat e këtyre fenomeneve nuk formojnë, në gjykimin e misionit vëzhgues, shkak për pavlefshmëri, përndryshe deklarata nuk do t'i konsideronte zgjedhjet si zgjedhje ku “votuesit mund të zgjidhnin midis kandidatësh, të cilët mund të bënin lirshëm fushatë, me një kuadër ligjor që respekton liritë themelore” dhe ku “zgjedhjet ishin në përgjithësi të mirorganizuara” (faqe 1).

28. Për sa i përket pretendimit të paditësit Kreshnik Merxhani se në tabelën përmbledhëse të rezultateve mungon subjekti i trembëdhjetë, kandidati i pavarur; ky pretendim nuk mbështetet, pasi tabela është vetëm për subjektet zgjedhore parti ose koalicione. Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vëren se pala paditëse ka bërë një interpretim të gabuar të rolit dhe funksionit që ka tabela në administrimin e procesit. Pretendimi tjetër i paditësit Kreshnik Merxhani lidhur me pamundësinë për të lexuar nga materialet e videove, një numër të kufizuar fletësh votimi, nuk mbështet dot kërkesën e tij për pavlefshmërinë e zgjedhjeve. Vlen të theksohet se në një pjesë të rasteve, fleta tregon votë për subjekte të tjera, por nuk zbulon nëse ka patur shënime mbi kandidatët e pavarur. Këto raste nuk tregojnë tjetërsim në masë të rezultatit të zgjedhjeve, që do të ishte kusht për pavlefshmëri.

29. Pala paditëse Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim kërkoi nga Kolegji Zgjedhor Gjyqësor që të merrte në cilësinë e provës 19 informacione specifike nga institucione të ndryshme që veprojnë në territor. Kolegji, pasi dëgjoi edhe mendimin e palëve të tjera ndërgjyqëse, vendosi rrëzimin e saj për shkak se u vlerësua se këto informacione të kërkuara për t'u marrë nuk ishin mjaftueshmërisht konkrete për nevoja të këtij gjykimi. Pala paditëse nuk referoi tek asnjë dokument konkret zyrtar i këtyre institucioneve ku mund të gjendeshin informacionet e kërkuara, pavarësisht se është në detyrimin e tij të identifikojë provën dhe të tregojë se ku ndodhet ajo.

30. Përsa u analizuan më sipër, Kolegji çmon se pretendimet e palëve paditëse janë të pambështetura në prova dhe në ligj, dhe për pasojë paditë e palëve paditëse Kreshnik Merxhani, Partia Lëvizja Socialiste për Integrim dhe Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim duhet të rrëzohen.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, bazuar në Ligjin nr.10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i përditësuar,

V E N D O S I

- Rrëzimin e padive të palëve paditëse Kreshnik Merxhani, Partia Lëvizja Socialiste për Integrim dhe Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim, si të pambështetura në prova dhe në ligj.
- Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk lejohet ankim.
- U shpall në Tiranë, sot më datë 31.05.2021.

GJYQTAR
Gentian MEDJA

GJYQTARE
Manjola XHAXHO

GJYQTARE
Alma KOLGJOKA

GJYQTAR
Sokol IBI

GJYQTAR
Asim VOKSHI